



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Didaktikë e gjuhës angleze

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione/20 seminare

Viti / Semestri : Viti III , Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Bachelor në gjuhën angleze

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kursi synon të pajisë studentët me njohuri bazë teorike mbi mësimin e gjuhës së huaj në shkollë, me theks te glotodidaktika dhe zhvillimi historik i saj. Ai synon të ndihmojë studentët të kuptojnë dhe të dallojnë metodat dhe teknikat e mësimdhënies, si dhe t'i zbatojnë ato në kontekstin e klasës.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të njohin konceptet themelore të didaktikës dhe qasjet e saj ndaj mësimit të gjuhëve të huaja.
2. Të analizojnë rolin e mësuesit dhe të nxënësit në procesin mësimor.
3. Të reflektojnë mbi qëndrimet e tyre ndaj mësimit të gjuhës së huaj.
4. Të përvetësojnë teknika që nxisin të nxënit aktiv dhe efektiv në një kontekst në ndryshim.

Rezultatet e pritshme : Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje :

1. Të identifikojnë dhe zbatojnë metoda e teknika të mësimdhënies së gjuhës së huaj në mënyrë të përshtatshme për nivelin dhe kontekstin shkollor.
2. Të kuptojnë zhvillimin historik dhe konceptual të didaktikës dhe do të zhvillojnë aftësi për të reflektuar mbi praktikën mësimore, për të përmirësuar qasjet e tyre dhe për të nxitur të nxënit aktiv të nxënësve.